



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:160929

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06434960

KPPP.nr. 898/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Golden Eagle” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811484138 dhe seli në Suharekë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Qazim Hasanaj, avokat nga Suhareka, kundër debitorit “Edde Holding” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811517822 dhe me seli në Obiliq, Milloshevë, Magjistratja Prishtinë-Mitrovicë, km 10, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 424/24 e datës 07.05.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Liridon Tërshani me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 11.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Edde Holding” Sh.P.K, ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr.424/24 i datës 07.05.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Liridon Tërshani, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “GOLDEN EAGLE” Sh.P.K, me datë 07.05.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 424/24 duke lejuar përmbareimin ndaj debitorit “Edde Holding” Sh.P.K., mbi bazë të dokumentit të besueshëm: Faturë Nr. 1-2/55374 e datës 30.12.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit borxhin e tërësishëm në shumën prej 1,121.82 EUR (njëmijë e njëqind e njëzet e një euro e tetëdhjetë e dy cent), me kamatë prej 8% nga data e arritshmërisë së pagesës për faturën e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore me arsyetimin se i njëjti është i lëshuar në kundërshtim me nenin 29, par.1.3, neni

37 dhe nenit 38 par.1 të LPP-së sepse shuma nuk është reale. Ka shtuar se në faturë është theksuar vlera e faturës pa TVSH 991,44 EURO ndërsa vlera për pagesë 1,1128.82 EUR. Tutje shton se fatura nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm ku në të njëjtën ditë që është lëshuar fatura, në të njëjtën ditë kërkohet përmbushja e borxhit dhe se nuk ka asnjë provë se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditore në përgjigjen në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin dhe ka kërkuar që i njëjti të refuzohet, duke theksuar se fatura objekt i përmbarimit i plotëson të gjitha kriteret për të qenë dokument i besueshëm dhe se fatura është nënshkruar dhe vulosur nga debitori, po ashtu shton se në faturë afati i pagesës ka qenë 8 ditë. Tutje shton se prapësimi është bërë në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, pasi që nuk përmban asnjë prej shkaqeve që duhet të i përmbajë një prapësim. Shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar si tarifës së OAK-ut.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumentet e besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri përmbarimor P.nr.424/24 i datës 07.05.2024 bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën Nr.1-2/55374 e datës 30.12.2023 e cila i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditore dhe debitori, janë të përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është

përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata po ashtu gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e evidentuar tek pranuesi i faturës, e po ashtu fatura i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë është e përshtatshme për përmbarim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Në vlerësimin e pretendimeve të debitorit, gjykata gjeti se nuk plotësohen asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 898/24, datë 11.11.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.